

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: “*Rehabilitim objekte sportive*”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **45212290-5**

PËRCAKTIMI DHE ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE :

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet/Relacioni Teknik/preventiv dhe grafiku per proceduren respektive jane hartuar nga grupi qe ka hartuar edhe projekt/ preventivin perkates te zbatimit specialiste te fushës. *Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë kontrolluar dhe janë gjetur në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”i ndryshuar.* Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

Vendosja dhe argumentimi i kriterëve/Hartimi i kërkesave për kualifikim lidhur me kapacitetet teknike, argumentimi i numrit te punonjesve dhe numrit te mjeteve dhe makinerive për këtë objekt prokurimi është bërë nga specialisti i fushës, në respektim dhe të parashikimeve të nenit 74/4 të të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

VLERA E FONDIT LIMIT:

4,165,972 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa tvsh

4,999,166(katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë me tvsh

Preventivi i perllogaritur per kete procedure eshte hartuar sipas VKM Nr 216 date 13.04.2023, në zbatim të urdhërit të brendshëm të titullarit të AK “Mbi Përgatitjen e kriterëve Teknike dhe Përllogaritjen e Vlerës Limit të planifikuar për tu kryer në programet e investimeve, bazuar ne dokumentat sipas buxhetit te bashkise te vitit 2026 të miratuara nga Këshilli Bashkiak si dhe dokumentave lidhur me projektin, preventivin dhe specififikimet teknike të punimeve.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”,i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c ,i ndryshuar dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,i ndryshuar,autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Maliq** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

SPECIFIKIMI I ÇMIMEVE

Gërmim dhe seksion I detyruar

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m³ germim dhe themel pavarësisht nga kategoria e tokës. Germimi te behet duke patur parasysh detajet teknike dhe permasat përkatëse në projekt-preventiv.

Germimi duhet te kryhet ne perputhje me nivelet dhe vijen e prerjeve sic tregohet ne Vizatime.

Përmasat e prerjeve duhet te jene ne perputhje me detajet e seksione terthore tip sic tregohen ne Vizatime.

- **Beton C – 6 /10**

Në këtë çmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m³ beton C – 6 /10 për ndërtimin e shtresës së varfër te betonit me trashësi 10 cm nen themelin e shtyllave të rrethimit sipas detajit dhe projektit teknik përkatës duke respektuar kushtet teknike të zbatimit. Ne çmim futet teresia e shpenzimeve per prodhimin ose blerjen e materialeve inerte, cemento, transportin, pergatitjen e armaturave me derrese te stazhionuar ose metalike, pergatitjen e betonit dhe hedhjen ne veper, trajtimin me uje per realizimin e markes te kerkuar. Ne cmim futen dhe testet e bera per marken e betonit. Betoni te merret I gatshem nga nje nyje e mekanizuar ose te prodhohet me betoniere ne objekt sipas kushteve teknike dhe standartet..

- **Beton C – 16 /20**

Në këtë çmim parashikohet tëresia e shpenzimeve që nevojiten per realizimin e 1 m³ beton C – 16 /20 për ndërtimin e shtresës së betonit me trashësi 10 cm mbi shkallët e gurit sipas detajit dhe projektit teknik përkatës duke respektuar kushtet teknike të zbatimit. Ne çmim futet teresia e shpenzimeve per prodhimin ose blerjen e materialeve inerte, cemento, transportin, pergatitjen e armaturave me derrese te stazhionuar ose metalike, pergatitjen e betonit dhe hedhjen ne veper, trajtimin me uje per realizimin e markes te kerkuar. Ne cmim futen dhe testet e bera per marken e betonit. Betoni te merret I gatshem nga nje nyje e mekanizuar ose te prodhohet me betoniere ne objekt sipas kushteve teknike dhe standartet..

- **Beton C – 20/25**

Ne këtë cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m³ beton C – 20/25 për ndërtimin themelit (tip tra) ku do të fiksohen shtyllat metalike Ø 60,3 dhe 48 mm sipas detajit të themelit dhe projektit teknik përkatës (Plan vendosje Planimetri, Prerje, Pamje etj) Në këtë çmim futet teresia e shpenzimeve per prodhimin ose blerjen e materialeve inerte, çimento, transportin, pergatitjen e armaturave me derrese te stazhionuar ose metalike, pergatitjen e betonit dhe hedhjen ne veper, ngjeshjen me vibrator, trajtimin me uje për realizimin e markës të kërkuar dhe dizarmimin e armatures. Ne cmim futen dhe testet e bera per marken e betonit. Betoni te merret I gatshem nga nje nyje e mekanizuar ose te prodhohet me betoniere ne objekt sipas kushteve teknike dhe standartet në fuqi.

- **Shtresë çakëlli makinerie t=10/15cm (Nënshtresa me material te granular).**

Ky zë parashikon ndërtimin e nënshtresës me çakëll mbeturina gurore. Shtresat me çakëll duhet të jenë të granulara me fraksione 0-31.5mm (për trashësi të shtresës t=10cm) dhe me fraksione 0 – 50 mm për trashësi të shtresës t=15cm. Çakëlli mbeturina (ose zhavorri) duhet të plotësojë këto kushte:

- Indeksi i plasticitetit nuk duhet të kalojë 10

- Nuk duhet të përmbajë grimca me përmasa mbi 2/3 e trashësisë së shtresës, në sasi mbi 5%.

- Nuk duhet të përmbajë mbi 10% grimca të dobëta dhe argjilore.

Vlera minimale e ngjeshjes duhet të jetë 95% e vlerës së Proktorit të Modifikuar, kjo e matur ne vendet në gjendje të thatë të shtresës së ngjeshur.

Shtresa e ngjeshur do të plotësojë të gjitha kërkesat për trashësinë, kuotën, seksionin tërthor dhe densitetin. Trashësia maksimale e nënshtresës (subbase) e ngjeshur duhet të jetë t=10cm ose t=15cm(sipas seksionin tip).

- **Shtresë stabilizanti t=5cm (Nënshtresa me material të granular).**

Ky zë parashikon ndërtimin e nënshtresës me stabilizant(çakëll i thyer dhe i granular). Shtresat e stabilizantit duhet të jenë të granulara me fraksione 0-20mm.

Shtresa e stabilizantit e ngjeshur do të plotësojë të gjitha kërkesat për trashësinë, kuotën, seksionin tërthor dhe densitetin. Trashësia e shtresës shkon në përputhje me pjerësinë e fushës.

- **Shtresat asfaltike**

- Shtresa e binderit (ose asfaltobetonit poroz). Kjo shtrese përdoret për shtresën lidhëse ndërmjet shtresës së stabilizantit dhe shtresës së asfaltobetonit. Materiali për shtresën e binderit (asfaltobetonit poroz) përgatitet me 60 deri 75% çakëll të thyer, 20 deri në 35% rërë dhe që mbas ngjeshjes ka porozitet mbetës 5 deri 10% në vëllim. Kjo shtresë parashikohet të realizohet me trashësi $t=4\text{cm}$

- Shtresa e Asfaltobetonit me ngjyrë (asfaltobeton i ngjeshur). Kjo shtresë përdoret si shtresë përdoruese (shtresa konsumuese). Materiali për këtë lloj shtrese përgatitet me çakëll të thyer e granil në masë 35 deri 40%, rërë 50% dhe pluhur 5 deri 15% dhe që mbas ngjeshjes ka porozitet mbetës në masën 3 deri në 5% në volum. Kjo shtresë parashikohet të realizohet me trashësi $t=3\text{cm}$.

Asfaltobetonit duhet të përgatitet në fabrika të posaçme, të cilat këshillohet të jenë sa më afër vendit të përdorimit të tij. Temperatura e masës së asfaltobetonit mbas shkarkimit nga përzierësi duhet të jetë në kufijtë 140-160 gradë celsius. Kur temperatura e mjedisit të jashtëm ku do kryhen punimet është 5 deri në 10 gradë celsius, kufiri më i ulët i temperaturës së asfaltobetonit duhet të jetë jo më pak se 150 gradë Celsius.

Transporti i asfaltobetonit duhet të bëhet me mjete vetëshkarkuese. Karrocëria e tyre parangarkesës duhet të jetë e pastër, e thatë dhe e lyer me përzierës solari të holluar me vajgur, për të mënjanuar ngjitjen e masës së asfaltobetonit. Këshillohet që karrocëria e mjetit të jetë e mbuluar, për të mbrojtur asfaltobetonin nga lagështia dhe të ngadalësojë shpejtësinë e ftohjes së masës gjatë transportit.

- **Shtrimi dhe ngjeshja e asfaltobetonit**

a) Ndërtimi i shtresave asfaltike rrugore fillon të kryhet mbasi të kenë përfunduar punimet e themelit (në shtresat rrugore) dhe të jenë plotësuar treguesit teknik, në lidhje me ngjeshmërinë ose aftësinë mbajtëse të tyre, kjo në përputhje me kërkesat e projektit.

b) Trashësia e shtresës së asfaltobetonit në momentin e shtrimit (në gjendje të shkrifët) duhet të jetë 1.20% deri 1.25% më me e madhe se trashësia e dhënë në projektzbatim në gjendje të ngjeshur.

c) Temperatura e masës së asfaltobetonit në momentin e shtrimit në rrugë duhet të jetë në kufijtë 130-150 gradë Celsius. Në kohë të nxehtë jo më pak se 130 gradë celsius dhe në kohë të ftohtë (kur temperatura e mjedisit të jashtëm është 5-10 gradë celsius të jetë jo më pak se 140 gradë celsius).

- d) Ngjeshja e shtresës së asfaltobetonit duhet të kryhet menjëherë mbas shtrimit të tij në rrugë. Cilindri ngjeshës duhet të ndjekë nga pas makinerinë asfaltoshtuese duke qëndruar në largësi deri 4m, me qëllim që ngjeshja të kryhet në gjëndje sa më të nxehtë.
- e) Për rrugë me pjesë kaluese mbi 5.0m, ngjeshja e shtresës së asfaltobetonit për gjysmën e parë të rrugës fillon nga kufiri me bankinën, ndërsa për gjysmën tjetër nga fuga gjatësore, e cila mund të jetë aksi i rrugës.
- f) Makineritë që përdoren për ngjeshjen e shtresave të asfaltobetonit duhet të jenë rula të zakonshëm me pesha të ndryshme nga 5 deri në 12 ton ose rula me vibrim.
- g) Kur përdoren për ngjeshje rula të zakonshëm, numri i kalimeve luhatet në kufij 12 deri 17 herë, ndërsa kur përdoren rula vibrues, numri i kalimeve ulet në masën deri 50%.
- k) Në fillim të ngjeshjes, cilindri në kalimet e para (deri 4 kalime) duhet t'a bëjë në të gjithë sipërfaqen e shtresës së asfaltobetonit duke ecur me shpejtësi 2 deri në 2.5km/orë. Ngjeshja duhet të bëhet me kujdes, në mënyrë që të mënjanohen rrudhosjet e shtresës.
- l) Në kohë të nxehtë, fillimisht ngjeshja e shtresës së asfaltobetonit bëhet me rulo me peshë të lehtë 5 deri 7 ton dhe më pas vazhdohet me rulo me peshë 10 deri në 12 ton, ndërsa në kohë të ftohtë, ngjeshja fillohet me rulo të rëndë 10 – 12 ton dhe më pas vazhdohet me rulo të lehtë, shpejtësia e lëvizjes së rulit duhet të jetë në kufijtë 2 deri 4km/orë.
- m) Në rastet kur është e pamundur të futen makineritë ngjeshja e shtresës asfaltike mund të kryhet me tokmak ose pllaka të nxehta.
- n) Cilindri ngjeshës në çdo kalim duhet të shkelë në gjurmën e mëparshme jo më pak se 0.25 të gjerësisë së tij.
- o) Ngjeshja e asfaltobetonit quhet e përfunduar atëherë kur mbi sipërfaqen e asfaltuar cilindri gjatë kalimit të tij nuk lë më gjurmë.
- p) Cilindri i rulit gjatë punës për ngjeshjen e shtresës së asfaltobetonit duhet të lyhet vazhdimisht me solucion solari të holluar me vajgur për të mënjanuar ngjitjen e kokrrizave të bituminuara në të.
- q) Nuk lejohet që ruli të qëndrojë në shtresën e asfaltobetonit të pangjeshur plotësisht ose të bëjë manovrime të ndryshme mbi të.
- t) Kur shtrimi i asfaltobetonit kryhet pa ndërprerje dhe përbëhet nga dy shtresa, këshillohet që shtresa e asfaltobetonit (shtresa konsumuese) të bëhet 24orë pas hedhjes së shtresës së binderit.

u) Për të mënjanuar rrudhosjen e shtresave të asfaltobetonit në rrugët, që kanë pjerrësi gjatësore mbi 6% është e domosdoshme që të sigurohet sipërfaqe e ashpër e shtresës së asfaltobetonit duke përdorur për prodhimin e tij çakëll kokërrmadh dhe ngjeshja me cilindër të kryhet duke filluar nga pjesa më e ulët.

v) Fugat të cilat krijohen gjatë shtrimit të asfaltobetonit në kohë të ndryshme duhet të trajtohen me kujdes te veçantë, për të mënjanuar boshllëqet që mund të krijohen në to.

Këshillohet që të respektohen rregullat që vijojnë:

v-1) Fugat midis shtresës së binderit dhe shtresës përdoruese të asfaltobetonit duhet që në çdo rast të jenë të larguara nga njëra-tjetra në kufijtë 10 deri 20cm.

v-2) Para fillimit të shtresës pasardhëse të asfaltobetonit, shtresa e mëparshme duhet të pritet me daltë duke e bërë fugën të pjerrët me kënd 45 gradë.

v-3) Para fillimit të shtresës së asfaltobetonit fuga lyhet me bitum dhe në buzë të saj vendoset listelë druri, e cila kufizon trashësinë e asfaltobetonit të shkrifët dhe nuk lejon asfaltin e freskët mbi shtresën e ngjeshur më parë. Kur fillon ngjeshja hiqet listela dhe cilindri duhet të bëjë ngjeshjen duke shkelur jo më pak se 20cm fugën. Mbas përfundimit të ngjeshjes, fuga në të dyja anët e saj në një gjerësi prej 6cm duhet të lyhet me bitum.

w) Në rastet kur shtresa e asfaltobetonit (shtresa konsumuese apo përdoruese) shtrohet mbasi shtresa lidhëse (binderi) i është nënshtruar me parë lëvizjeve të automjeteve, duhet detyrimisht të pastrohet sipërfaqja e saj nga papastërtitë e pluhuri, të mos përmbajë lagështi dhe të spërkatet me bitum të lëngshëm (në sasi deri 0.6 kg/m²) para fillimit të hedhjes së shtresës asfaltobetonit (shtresa konsumuese apo përdoruese).

- **Kontrolli mbi cilësinë e asfaltobetonit të shtruar**

a) Sipërfaqja e shtresës së asfaltobetonit duhet të jetë e lëmuar, e rrafshët dhe e njëtrajtshme, të mos ketë plasaritje, gungëzime ose valëzime, të mos ketë porozitet e ndryshime në kuota. Shtresa asfaltike duhet të ketë pjerrësi dhe trashësi, sipas detajit të dhënë në projektin e zbatimit.

b) Ndryshimet në kuotat anësore të rrugës nuk duhet të jenë më shumë se 20mm në krahasim me kuotat e përcaktuara në profilin tërthor të projektit.

c) Valëzime të matura si në drejtim tërthor, ashtu dhe në atë gjatësor të rrugës nuk duhet të jenë më shumë se 5 mm.

d) Ndryshimet në trashësinë e shtresës krahasuar me ato të përcaktuara në projekt nuk duhet të jenë më shumë se 10%.

e) Kontrolli që përcakton cilësitë kryesore të asfaltobetonit të vendosur e ngjeshur në vepër përcaktohen me prova laboratorike. Për këtë qëllim për çdo segment rruge të përfunduar ose për sasi deri në 2500m² asfaltobetonit të shtruar rruge, nxirren mostra me madhësi 25 x 25 cm mbi të cilat kryhen prova laboratorike për përcaktimin e vetive fiziko-mekanike. Vlerat e tyre krahasohen me kërkesat e projektit ose të STASH 660-87.

f) Për çdo segment rruge të shtruar me asfaltobeton duhet të mbahet akt-teknik, ku të pasqyrohen të gjitha të dhënat e kontrollit me pamje, matje e laboratorit dhe të miratohet nga përfaqësuesit e investitorit dhe firmës zbatuese, kur treguesit cilësorë janë brenda kufijve të kërkuar nga projektuesi ose kushtet teknike.

- **Ndertim pusete me zgare gize per ujrat e shiut. C – 16 / 20**

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 cop pusete shiu beton C – 16 / 20. Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per germimin e dheut per prodhimin ose blerjen e materialeve inerte , cimento, transportin , pergatitjen e armaturave me derrese te stazhionuar ose metalike ,pergatitjen e betonit dhe hedhjen ne veper , ngjeshjen me vibrator , dhe trajtimin me uje per realizimin e markes te kerkuar dhe dizarmimin e armatures dhe per vendosjen e kapakun te gizes . Ne cmim futet dhe testet e bera per marken e betonit. Betoni te merret i gatshem nga nje nyje e mekanizuar ose te prodhohet me betoniere ne objekt sipas kushteve teknike dhe standartet, me rere guri + cakell, te realizohet marka e kerkuare betonit. Ne cmim futet dhe testet e bera per marken e betonit. Te perdoret rere guri.

- **Ndertim pusete 0.4x0.4 x1m**

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 cop pusete shiu beton C – 16 / 20. Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per germimin e dheut per prodhimin ose blerjen e materialeve inerte , cimento, transportin , pergatitjen e armaturave me derrese te stazhionuar ose metalike ,vendosjen e hekurit,pergatitjen e betonit dhe hedhjen ne veper , ngjeshjen me vibrator , dhe trajtimin me uje per realizimin e markes te kerkuar dhe dizarmimin e armatures dhe per vendosjen e kapakun te gizes . Ne cmim futet dhe testet e bera per marken e betonit. Betoni te merret i gatshem nga nje nyje e mekanizuar ose te prodhohet me betoniere ne objekt sipas kushteve teknike dhe standartet, me rere guri + cakell, te realizohet marka e kerkuare betonit. Ne cmim futet dhe testet e bera per marken e betonit. Te perdoret rere guri.

F.V. Tub korogato $\varnothing = 200$.

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per furnizimin dhe vendosjen e 1 ml tubo korogato $\varnothing = 200$ ne veper qe ploteson te gjitha kushtet teknike dhe kerkesave te projektit. Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per piketimin, blerjen e materialeve, transportin dhe vendosjen ne veper sipas profilave terthor. Tubot duhet te jene te shoqeruar me certifikaten e cilesise

- **Ndertim mur guri dekorativ llac cemento M 15**

Ne kete çmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m³ mur guri mbajtës dekorativ ll.ç. M=15 per ndertimin e mureve sipas detajit teknik me gjeresi dhe lartesi sipas projektit. Pjesa ballore e murit do te behet me fugatim. Ne çmim futet tërësia e shpenzimeve per blerjen e materialeve rërë guri, çimento, gurë gelqelore, transportin. Ne cmim futet dhe testet e bera per marken e gurit. Llaci te prodhohet me betoniere ne objekt sipas kushteve teknike dhe standartet, me rere guri, te realizohet marka e kerkuar e llacit.

- **F.V. Hekur betoni**

Ne këtë çmim parashikohet tërësia e shpenzimeve që nevojiten për F.V. ne veper e 1 ton hekur betoni i zakonshem $\varnothing 6 \sim 10\text{mm}$. Ne çmim futet teresia e shpenzimeve per blerjen e materialeve si hekur sipas \varnothing në projekt preventiv, tel bari, transportin, përgatitjen e hekuit dhe lidhjen ne veper sipas projektit.

- **F.V. Konstruksiione metalike**

Në këtë çmim parashikohet tërësia e shpenzimeve që nevojiten per F.V. ne veper e 1 ton hekuri dhe lyerjen me bojë vaji. Ne çmim futet tërësia e shpenzimeve për blerjen e materialeve si tubo çeliku profil rrethor $\varnothing 60.3 \text{ mm } \delta=3.25\text{mm}$ dhe 48mm me $\delta=2.9\text{mm}$ sipas projektit dhe preventivit përkatës, transportin, përgatitjen e hekurit dhe vendosjen ne themel sipas projektit (plan vendosje,plaimetri e objektit, pamje, prerje, detaje etj).

- **F.V. Rjetë me fije çeliku e galvanizuar në formë rombi 50x50 mm me trashësi $\delta=2.9\text{mm}$ me peshë 4 kg/m².**

Në këtë çmim parashikohet tërësia e shpenzimeve që nevojiten për F.V. në veper e 1m² rjetë metalike e plastifikuar. Në çmim futet tërësia e shpenzimeve për blerjen e rjetës metalike të plastifikuar, transportin, përgatitjen dhe vendosjen në shtyllat e rrethimit (deri në lartësinë 2.5 m) sipas projekt preventivitet përkatës (plan vendosje,plaimetri e objektit, pamje, prerje, detaje etj).

- **F.V. Rjetë polietileni për pritjen e topit, në formë katrore 13x13cm e trajtuar kundër rezeve UV me fije të paktën $\delta=2.5\text{mm}$.**

Në këtë çmim parashikohet tërësia e shpenzimeve që nevojiten për F.V. në veper e 1m² rjetë polietileni formë katrore 13x13 cm e trajtuar kundër rezeve UV trashësi $\delta=2.5\text{mm}$. Në çmim futet tërësia e shpenzimeve për blerjen e rjetës, transportin, përgatitjen dhe vendosjen në shtyllat e rrethimit (nga lartësia 2.5 m deri 5.5 m) sipas projekt preventivitet përkatës (plan vendosje,plaimetri e objektit, pamje, prerje, detaje etj).

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 ,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP,i ndryshuar, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Per kapacitetin ligjor /profesional te operatoreve ekonomike:

Sipas kritereve te pergjithshme te Pranim / Kualifikimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të vërtetuar të bilancit për vitet 2023-2024-2025 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, i ndryshuar, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumë prej 50 milionë lekësh;
- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumë prej 100 milionë lekësh;
- iii) ka, mesatarisht, 50 të punësuar gjatë periudhës kontabël."

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme ,nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, i ndryshuar, (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.2 Kopje të deklaratave për xhiron vjetore të viteve 2023,2024,2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

(Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 1 dhe pika 3 , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: ” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin 9920 datë 19.05.2008 ,për ”Procedurës Tatimore ”neni 64 Deklarata Tatimore.

” Vendosja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, për vitin 2026 ,pranë njësive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitet sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar dhe për vitin 2026(**këstet e maturuara të vitit 2026**) sipas percaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse,

bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimevetë nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet te deklaroje se ka :

a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së kontratës që prokurohet ,dhe që është realizuar gjatë **pese viteve** të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marre së bashku gjatë **pese viteve** të fundit të jete **jo me e vogel se fondi limit i kontrates** **qe prokurohet.**

Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

**Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike, Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me **sektorin publik** Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon **vërtetime** të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me **sektorin privat**, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi, **vërtetime**, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me **fatura tatimore** të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose sa vlera e fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori ekonomik duhet të dorëzojë:

a. Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

1. NP 1 - A (Punime gjurmimi)
2. NP 2 - A (Ndërtim civil dhe industrial)

*Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të liçencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë liçencat profesionale sipas zerave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr persiper të realizojë).

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi I kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve (pa tvsh) që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	<i>Punime gjurmimi në tokë</i>	Punime gjurmimi me eskavator	A	
NP-2	<i>Ndërtim civil dhe industrial</i>	Punime për rrethimin e kalçetos, punime shtresash, punime guri	A	

NP-1A (Punime gjurmimi në tokë)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi “Sportive Bregas (Kalçeto) faza e II”, ka zëra pune që lidhen me gjurmime në tokë, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NP-2A (Ndërtim civile dhe industriale)

Duke marrë në konsideratë objektin e prokurimit, i cili lidhet me Terene Sportive ,është e nevojshme që Operatori ekonomik të jetë i licensuar me kete kategori license.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar, nenin39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar., si dhe Ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Vendimit Nr. 943, datë 28.12.2016 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të këshillit të ministrave, "për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim"

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një **Deklarate (nga Administratori i shoqërisë), Drejtuesin Teknik** të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë te perfshirë në licensën e shoqërisë. Drejtuesi teknik duhet te jete :

- Inxhinier Ndertimi (1)

“Në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit,si më poshtë :

1. Kontratë pune (e vlefshme)
2. Diplomë

Argumentimi: Për kriteret e përcaktuara në pikën 2.3.3. Njësia e Prokurimit është bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162,”Për Prokurimin Publik” datë 23.12.2020, pika 4 si dhe në VKM nr 285 datë 19.05.2021 “për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” neni 39 pika 6 c.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Inxhinieri ndërtimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve. Ai ben menaxhimin e punimeve ne terren,kordinimin e ekipit dhe dokumentacionin teknik Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve që vendosen në objekt.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te deklaroje sipas formularit te vetdeklarimit se ka një punonjës i cili është i pajisur me Çertifikate trajnimi për *”Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune”*, e dhëne nga nje organizem i licensuar certifikimi shqiptar ose i huaj
Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë,ky kusht quhet i plotesuar edhe kur vetem 1 operator ekonomik paraqit dokumentat per punonjesin te pajisur me certifikate trajnimi për ”Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune”.

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin Nr.10237 datë 10.02.2020”Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, dhe ligjit nr.16/ 2014 I ndryshuar

2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në formularin e vetdeklarimit se ka të punësuar, minimalisht **8** punonjës të kualifikuar si më poshtë:

- **Manovrator (1)**

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

Kur mjetet janë në pronësi

1. kontrata e punës (e vlefshme)
2. Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Sherbimeve të Transportit Rrugor

Kur mjetet janë me qera

Deklarate nga operatori ekonomik, që në rastin e shpalljes fitues, do paraqesë kontratë pune me manovratorin(i cili duhet të ketë Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Sherbimeve të Transportit Rrugor) deri në perfundimin e afateve të kontratës.

- **Murator (2)**

- **Saldator (1)**

“Për punonjës të mësipërm në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

1. kontrata e punës e vlefshme;
2. Çertifikate për sigurimin teknik të punonjesve (e vlefshme);
ose
Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik

- **Punetore të thjeshtë (2)**

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

1. kontrata e punës e vlefshme;

- Punonjës shofer kamioni (1)

“Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit autoriteti kontraktor I kerkon ofertuesit I kualifikuar I pari ,dorezimin e dokumentave provuese si dhe dokumentat e tjera shoqeruese te ofertes te dorezuar ne menyre elektronike si me poshte:

Kur mjetet jane ne pronesi

1. kontrata e punës (e vlefshme);
2. leje drejtimi kategoria C

Kur mjetet jane me gera

1. *Deklarate nga operatori ekonomik, qe ne rastin e shpalljes fitues, do paraqese kontrate pune me shofer kamioni(i cili duhet te kete leje drejtimi kategoria C) deri ne perfundimin e afateve te kontrates.*

-Punonjës shofer kamioncine (1)

“Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit autoriteti kontraktor I kerkon ofertuesit I kualifikuar I pari ,dorezimin e dokumentave provuese si dhe dokumentat e tjera shoqeruese te ofertes te dorezuar ne menyre elektronike si me poshte:

Kur mjetet jane ne pronesi

1. kontrata e punës (e vlefshme);
2. leje drejtimi kategoria B

Kur mjetet jane me gera

1. *Deklarate nga operatori ekonomik, qe ne rastin e shpalljes fitues, do paraqese kontrate pune me shofer kamioni(i cili duhet te kete leje drejtimi kategoria B)deri ne perfundimin e afateve te kontrates.*

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet te deklaroje ne formularin e vetdeklarimit se ka një punësim mesatar i të paktën 9 (nente) punonjësish se bashku me stafin inxhinierik për muajin e fundit.

Kur operatori ekonomik i disponon mjetet me qira, do te paraqese deklarate per punonjestit (Punonjës shofer kamioncine (1), Punonjës shofer kamioni (1), Manovrator (1)), qe ne rastin e shpalljes fitues, punonjesit jane te siguruar ne Administrata Tatimore.

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

a. Vërtetim të lëshuar dhe konfirmuar (me firmë dhe vule) nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit.

Dhe

Listpagesat e konfirmuar (me firmë dhe vule) nga Administrata Tatimore të punonjësve sipas formatit që kërket nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Përprokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Përmiratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërket që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Vendosja e këtyre kriterëve për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është perlllogaritur në një kohë të shkurtër i cili kërkon fuqi punëtore të shtuar dhe me mjetet e kerkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.

- Murator (2)

Janë kërkuar 2 murator bazuar në zerat e preventivit, për mur guri mbajtës e themele, llaç çimento M15, shtresë betoni në mur, themel e bazamente b/a C20/, puseta shiu 40x40, si dhe vendosja e tubo plasamsi

- Manovrator (1)

Është kërkuar 1 manovrator bazuar në zerat e preventivit për gjërmim dhe me eskavator si dhe për drejtimin e makinerive të renda si rul, fadromë, asfaltoshturesë, autobitumatrice etj

- Saldator (1)

Është kërkuar 1 saldator bazuar në zerat e punimeve në preventiv për rrjetë polietileni në formë katrore 13x13 cm e trajtuar kundër rezeve UV tr.2.5 mm, për konstruksione metalike të thjeshta të lyera, si dhe vendosjen e portave alumini

- Punëtorë të thjeshtë (2)

Janë kërkuar 2 punëtorë të thjeshtë për punime të ndryshme sipas të gjitha zërave në preventive

- Shofer kamioni (1)

Është kërkuar 1 shofer kamioni për drejtimin e kamionit veshkarkues

- Shofer kamionçine (1)

Është kërkuar 1 shofer për drejtimin e kamioncinës,

ZBERTHIMI I PREVENTIVIT:

Nr. Rend	Nr. analize	Përshkrimi i Punimeve	Njësia	Sasia	Orë pune /Njësi	Orë pune gjithsej
I		PUNIME GËRMIMI				
1	2.26a	Gërmim dheu me eskavator me goma 0,25m ³ , tokë kategoria e III me shkarkim në makineri b<2	m ³	51	0.07	3.42
	2.37/1a	Transport dheu me auto deri 1 km	m ³	190	0.20	38.00
II		PUNIME GURI				-
1	3.321	Mur guri mbajtës e themele, llaç çimento M15 (Muret mbajtës në perëndim)	m ³	55	9.3	511.50
2	2.262/4	Shtresë betoni në mur ,rugë kalimi në shkallë C16/20	m ³	1.1	8.6	9.46
III		RRETHIMI I KALÇETOS				-
1	2.262	Shtrese betoni C 6/10 (Beton nivelues nen themel)	m ³	1.35	8.6	11.61
2	2.262/4 a	Themel e bazamente b/a C20/25	m ³	2.9	8.6	24.94
3	3.287	F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm	ton	0.15	60	9.00
4	2.182	Konstruksione metalike të thjeshta të lyera (Shtylla metalike Ø 48 mm δ=2,9 mm)	ton	0.36	36	12.96
5	An	Rjetë polietileni në formë katrore 13x13 cm e trajtuar kunder rezeve UV tr.2.5 mm	m ²	144	0.1	14.40
IV		PUNIME SHITESASH				-
1	2.26	Gërmim dheu I fushës 15 cm, me eskavator me goma 0,25m ³ , tokë kategoria e III me shkarkim në makineri b>2	m ³	141	0.062	8.74
2	3.224/1 a	Shtrese asfaltobetoni me ngjyre me granil guri kave, 3cm, me makineri	m ²	938	0.082	76.92
3	3.221/1	Shtrese binderi me granil gur kave, 4cm, me makineri	m ²	938	0.10	91.92
4	3.212/a	Stabilizant për nivelim dhe pjerësi 5 cm	m ²	938	0.05	46.90
5	3.212	Shtrese çakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur me makineri (rulim dhe cilindrim)	m ²	938	0.07	67.54
6	2.341	Puseta shiu 40x40	copë	4	4.2	16.80

7	3.652	F.V Tubo plasmasi 200	ml	100	0.6	60.00
8	An-56	F.V Porta alumini + rrjeta futbollit(polietileni)	copë	2	8	16.00
9	3.942/4	Vijëzim shirita gjatësor dhe anësor me gjerësi 12 cm termoplastike (paste)	ml	230	0.20	46.00
		SHUMA				1,066.11

- Nga zbërthimi i preventivit orët e punës për çdo zë punimi rezultojnë 1066.11 orë
- Orët në total i pjestojmë me 8 orë pune ditore $1066: 8 = 133.26$
kemi 133 punëtorë për një ditë pune
- 133 punëtorë për një ditë punë pjestuar më 22 ditë pune mujore kemi 6 punëtorë për një muaj punë.
- Gjithashtu duhen edhe 1 shofer kamioni për të marrë në ngarkim 1 kamion veshkarkues , dhe 1 shofer për kamioncinën

2.3.7 Shoqëria duhet të paraqesë Çertifikata ISO

1. ISO 9001- 2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë).
2. ISO 14001-2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit).
3. ISO 45001-2023 (Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)

Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH ose standardeve shqiptare mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë çertifikata ISO, sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2023 është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2023 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qira mjetet e domosdoshme për realizimin e kontratës si më poshtë :

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
1. Eskavator me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
2. Betoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
3. Rul me vibrim	1 copë	Pronësi ose me qera
4. Autobitumatrice	1 copë	Pronësi ose me qera
5. Asfaltshtruese	1 copë	Pronësi ose me qera
6. Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
7. Motosaldatriçe	1 copë	Pronësi ose me qera
8. Fadrome	1 copë	Pronësi ose me qera
9. Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës 7-10 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
10. Kamioncinë me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton	1 copë	Pronësi ose me qera

(Shenim për kapacitetin mbajtës të mjeteve të kërkuara për realizimin e punimeve. Kapaciteti mbajtës i mjeteve sipas lejes së qarkullimit do llogaritet nga diferenca midis Mases maksimale me ngarkesë të plote të lejuar në Shqipëri dhe Mases së mjetit bosh.)

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

1. Leje qarkullimi (e vlefshme)
2. certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
3. Police sigurimi (e vlefshme)
4. Mjeti të shoqërohet me fotografi të dukshme
5. Certifikate për lejetransportiteleshuar nga Bashkia

dhe permjetet me qera,

1. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i saj i cili të jete i vlefshëm gjatë periudhës së kryerjes së punimeve.
2. Leje qarkullimi (e vlefshme)
3. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
4. Police sigurimi (e vlefshme)

5. Mjeti te shoqerohet me fotografi te dukshme.]

6. Certificate per lejetransportiteleshuarnga Bashkia

Ne rastin e mjeteve te marra me qera nga operatoret ekonomike bazuar ne njoftimin e APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022 ,referuar dokumentacionit(leje qarkullimi,certificate e transportit te mallrave) ,mjetet nuk duhet te rezultojne per perdorim vetjak por per perdorim nga te tretet.

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten :

per mjetet ne pronesi :

- aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

permjetet me qera :

- të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i saj.

- aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

c) Deklarate nga Operatori ekonomik per makineritë e mësipërme te cilat nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata.

1- Eskavator me goma 1 copë

Është kërkuar 1 eskavator me goma bazuar në zërat e preventivit për germim dheu me eskavator

2- Betoniere 1 copë

Është kërkuar 1 betoniere bazuar në zërin e preventivit për krijimin e betonit

3- Rul me vibrim 1 copë

Është kërkuar 1 rul me vibrim bazuar në zërat e preventivit për punime shtresash , ngjeshje të shtresave.

4- Autobitumatrice 1 copë

Është kërkuar një autobitumatrice bazuar në zërin e preventivit për spërkatjen me bitum

5- Asfaltoshtruese 1 copë

Është kërkuar një asfaltoshtruese bazuar në zërat e preventivit për punime shtresash, shtresë asfaltobetoni.

6- Autobot uji 1 copë

Është kërkuar 1 autobot uji bazuar në zërat e preventivit për punime shtresash ,lagien e materialeve para ngjeshjes

7- Motosaldatrice 1 copë

Është kërkuar 1 motosaldatrice bazuar në zërat e preventivit për vijëzim shirita gjatsore dhe anësor me gjerësi 12 cm termoplastike (shkrin dhe mban nxehtë termoplastikun)

8- Fadromë 1 copë

Është kërkuar 1 fadrome bazuar në zerat e preventivit për të bërë përhapjen e materialeve në punimet për shtresat

9- Kamion vetshkarkues kapacitet mbajtës 7-10 ton 1 copë

Është kërkuar 1 kamion vetshkarkues për transportin e materialeve të ndryshme si dhe, cakëll, asfalt, stabilizant, binder etj

10- Kamioncinë kapacitet mbajtës 1.5- 2 ton 1 copë

Është kërkuar 1 kamioncine për transportin e materialeve dhe punëtorëve në vendin e punës.

***Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtoare, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).*